



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2794/4 prot

Datë 23.12.2022

V E N D I M

Nr. 1286/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.12.2022 me

- Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes së ankesës së operatorit ekonomik “TIRANA AUTO” SHPK nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-49021-11-07-2022, me objekt: Loti 1: “Blerje automjetesh elektrike për nevoja të FSHZH-së”, me fond limit 25 867 478 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 24.11.2022 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
- Autoriteti Kontraktor:** Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Rruga “M.Gjollesha, ish-Godina ISTN (pranë IKMT), Tiranë
- Ankimues:** “TIRANA AUTO” SHPK
Aut. TR-DR, Km 1
- Subjekte të Interesuar:** “Classic” SHPK
Autostrada Tirane-Durres, km 1, rruga dytesore, godina nr 8, Kashar, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin

dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

- I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.
- I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.
- I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.
- I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

- II.1. Në datën 08.11.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-49021-11-07-2022, me objekt: Loti 1: “Blerje automjetesh elektrike për nevoja të FSHZH-së”, me fond limit 25 867 478 lekë pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
 - II.2. Në datën 24.11.2022 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.
 - II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton, se në datën 02.12.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
- Operatori ekonomik ankimues “TIRANA AUTO” SHPK, rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit me arsye si më poshtë vijon:

Subjekti skualifikohet per arsye se:

-Certifikata ISO 9001 nuk eshte e vlefshme pasi ka skaduar ne daten :14.08.2022

-Nuk ploteson kriterin 2.3.7 te kriterëve te vecanta pasi profili i inxhinierit mekanik nuk eshte sipas kerkesave te DST-se”

II.4. Në datën 07.12.2022, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit për procedurën e prokurimit në sistemin elektronik të prokurimeve me rezultatet e vlerësimit si vijon:

“Classic” SHPK	25.850.000 lekë, kualifikuar
“Tirana Auto” SHPK	25.700.000 lekë, skualifikuar

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 14.12.2022, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2794 protokollit e operatorit ekonomik “TIRANA AUTO” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-49021-11-07-2022, me objekt: Loti 1: “Blerje automjesh elektrike për nevoja të FSHZH-së”, me fond limit 25 867 478 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 24.11.2022 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Në të njëjtën datë ankimesi ka paraqitur ankesë edhe pranë autoritetit kontraktor. Në ankesë kërkohet shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “TIRANA AUTO” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr. 2794/2 prot., datë 15.12.2022 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimes “TIRANA AUTO” SHPK.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 3991/1 prot., datë 15.12.2022 me objekt: “Kthim përgjigje ankimit datë 14.12.2022”, drejtuar shoqërisë ankimese dhe për dijëni KPP-së, protokolluar me tonën me nr. 2794/3 prot., datë 19.12.2022, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, vendimi i autoritetit kontraktor mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.8. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimes “TIRANA AUTO” SHPK dhe e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës.

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur

pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi skualifikimin e ofertës së tij, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar shkresës së autoritetit kontraktor me nr. 3991/1 prot., datë 15.12.2022 me objekt: “*Kthim përgjigje ankimit datë14.12.2022*”, drejtuar shoqërisë ankimuese dhe për dijëni KPP-së, protokolluar me tonën me nr. 2794/3 prot., datë 19.12.2022, rezulton, se KSHA-ja ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “TIRANA AUTO” SHPK dhe e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës.

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “*Për prokurimin Publik*” i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

Përsa më sipër, në kushtet kur operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të mbylljë çështjen lidhur me ankesën e operatorit ekonomik "TIRANA AUTO" SHPK për procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur", me Nr. REF-49021-11-07-2022, me objekt: Loti 1: "Blerje automjesh elektrike për nevoja të FSHZH-së", me fond limit 25 867 478 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 24.11.2022 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimi.

III.2. Lidhur me veprimet e ndërmarra nga autoriteti kontraktor për afatet e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik "TIRANA AUTO" SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në datën 07.12.2022, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit për procedurën e prokurimit në sistemin elektronik të prokurimeve.

III.2.2. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 14.12.2022, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2794 protokollit e operatorit ekonomik "TIRANA AUTO" SHPK për procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur", me Nr. REF-49021-11-07-2022, me objekt: Loti 1: "Blerje automjesh elektrike për nevoja të FSHZH-së", me fond limit 25 867 478 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 24.11.2022 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Në të njëjtën datë ankimesi ka paraqitur ankesë edhe pranë autoritetit kontraktor. Në ankesë kërkohet shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik "TIRANA AUTO" SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.2.3. Referuar shkresës së autoritetit kontraktor me nr. 3991/1 prot., datë 15.12.2022 me objekt: "Kthim përgjigje ankimit datë 14.12.2022", drejtuar shoqërisë ankimese dhe për dijëni KPP-së, protokolluar me tonën me nr. 2794/3 prot., datë 19.12.2022, rezulton, se KSHA-ja ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimes "TIRANA AUTO" SHPK dhe e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës

III.2.4. Në nenin 113 "Të drejtat e operatorëve ekonomikë të interesuar", të ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik" parashikohet shprehimisht:

1. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor për paraqitjen e këtyre argumenteve është 7 ditë nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 5 ditë.

2. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë prokurimi.

III.2.5. Përsa më sipër, rezulton se autoriteti kontraktor e ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ekonomik ankimues të paraqitur në datën 14.12.2022 dhe ka dalë me vendim për pranimin e plotë të pretendimeve të paraqitura nga ky subjekt në datën 15.12.2022, duke mos pritur afatet kohore për paraqitjen e argumentave nga operatorët ekonomikë të interesuar.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimit, apo afati i paraqitjes së argumentave nga operatorët ekonomikë të interesuar etj, përfaqësojnë garanci juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (*Neni 9 i K.pr. Administrative*).

Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në neni 3 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë.

Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Në interpretim sistematik (domethënjen e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), Komisioni i Prokurimit gjykon se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet procedurale atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor (rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave)

Normativa e mësipërme, parashikuar nga neni 113 të LPP-së, rregullon të drejtën e operatorëve ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, ndaj dhe kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në rastin konkret rezulton se autoriteti kontraktor ka dalë me vendim në datën 15.12.202, pra ditën e nesërme nga depozitimi i ankesës në datën 14.12.2022 pranë këtij të fundit, duke mos pritur afatet kohore për paraqitjen e argumentave nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa, në kuptim të nenit 113 të LPP-së si më sipër cituar.

Komisioni i Prokurimit Publik tërheq vëmendjen e autoritetit kontraktor për parregullsitë e konstatuara si më sipër, dhe në rast përsëritjeje, do të propozohen masa administrative për personat përgjegjës, në zbatim të legjislacionit të prokurimit publik

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 , pika 1 dhe 2 e nenit 115 dhe neni 118 i ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19””, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “TIRANA AUTO” SHPK, lidhur me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-49021-11-07-2022, me objekt: Loti 1: “Blerje automjesh elektrike për nevoja të FSHZH-së”, me fond limit 25 867 478 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 24.11.2022 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “TIRANA AUTO” SHPK.
4. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri